



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 41, Datë 09/09/2017

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me Nr. 10, datë 02.02.2017, të paraqitur nga subjekti ankues, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në emër të znj. [Emri i personit] kundër Drejtorisë Arsimore Rajonale Shkodër dhe Shkollës 9-vjeçare “Vau i Dejës” Shkodër në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “Aftësisë së kufizuar” të nxënësit [Emri i nxënësit].

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

KONSTATOI:

Znj. [Emri i personit] në ankesën e paraqitur shkurtimisht shpjegon se: “Gjatë vitit shkollor 2016, mësuesi ndihmës i caktuar për djalin e saj nuk ka qenë i përshtatshëm për të ofruar asistencën që nevojitej për djalin, pasi nuk ka patur bashkëpunim mes tyre. Këtë shqetësim, znj. [Emri i personit] e ka paraqitur disa herë pranë drejtorit të shkollës 9-vjeçare, Vau i Dejës por nuk ka gjetur mbështetje. E ndodhur në këto kushte, ajo është detyruar që në muajin Tetor 2016 t’ia ndërrojë shkollën duke e regjistruar djalin pranë shkollës “3 Dhjetori” Shkodër. Znj. [Emri i personit] dëshiron që të rikthejë djalin e saj dhe njëherë pranë shkollës “Vau i Dejës”, por kërkon caktimi e një mësuesi ndihmës të kualifikuar për të punuar me fëmijë me aftësi të kufizuara”.

Ankuesja pretendon se mungesa e një mësuesi ndihmës të përshtatshëm ka cënuar zhvillimin e potencialit intelektual e fizik të djalit të saj në krahasim me nxënësit e tjerë të shkollës e për rrjedhojë e ka vendosur atë në pozita diskriminuese.

Për sa më sipër, subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi që të caktohet një mësues ndihmës, duke i siguruar nxënësit përshtatjen e arsyeshme dhe duke i krijuar mundësinë që të vazhdoj të studiojë pranë shkollës “Vau i Dejës” si dhe të vlerësohet mënyra e procedimit të DAR Shkodër për caktimin e mësuesit ndihmës, duke vlerësuar saktë nevojat e nxënësit [Emri i nxënësit].



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen dhe ka kërkuar nga ankuesi informacion më të plotë.

- Për këtë arsye, me shkresën nr. 141, datë 06.02.2017, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ka kërkuar ankuesit të paraqesë këto dokumente: - Kopje të ankesave/kërkesave të bëra nga znj. [Emri i fshehtë] drejtuar DAR Shkodër dhe Shkollës 9-vjecare Vau i Dejës mbi caktimin e një mësuesi ndihmës më të kualifikuar dhe përgjigjet e marra. - Kopje të kërkesës së znj. [Emri i fshehtë] për transferimin e fëmijës përsëri në shkollën Vau i Dejës dhe përgjigjet e marrë. - Kopje të PEI-t, vlerësimit përfundimtar në fund të vitit shkollor dhe vlerësimit të komisionit psiko-social të shkollës apo psikologut të shkollës Vau i Dejës për vitin shkollor 2015-2016. - Kopje të vlerësimit të Komisionit Multidisiplinar të DAR Shkodër në fillim të vitit shkollor 2016-2017 për nxënësin Mateo Prendi.

Deri më sot, subjekti ankues në mbështetje të pretendimeve të saj nuk ka vënë në dispozicion të Komisionerit fakte dhe prova për të provuar pretendimet e saja.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33/2, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/ç, 7 dhe 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore.

Hartoi: [Emri i fshehtë]

Miratoi: [Emri i fshehtë]

Datë: 07.03.2017



Irma BARAKU



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al